



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES**  
**DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE**

---

---

**URDHER**

**Nr. 194, Date 09.03.2009**

**“PER MIRATIMIN E RREGULLORES PER AUTORIZIMIN E PERSONAVE  
JURIDIKE PER KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NE METROLOGJINE  
LIGJORE DHE PER AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE DHE FIZIKE  
PER KRYERJEN E SHERBIMIT TE RIPARIMIT TE INSTRUMENTAVE  
MATESE”**

Ne zbatim te Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, neni 40, pika 4 dhe me propozim te Drejtorisë se Përgjithshme te Metrologjisë, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes,

**URDHERON:**

1. Miratimin e Rregullores “Për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive ne metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike për kryerjen e shërbimit te riparimit te instrumenteve matëse”, bashkëlidhur këtij Urdhri, ne te cilën përshkruhen kërkesat dhe procedurat për dhënien e këtyre autorizimeve.
2. Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**GENC RULI**

## RREGULLORE

### “PER AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE PER KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NE METROLOGJINE LIGJORE DHE PER AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE DHE FIZIKE PER KRYERJEN E SHERBIMIT TE RIPARIMIT TE INSTRUMENTAVE MATESE”

Kjo rregullore përshkruan kërkesat dhe procedurat për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive (shërbimeve) në metrologjinë ligjore si dhe për autorizimin e personave juridik ose fizik për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse që përdoren në metrologjinë ligjore. Sipas kësaj Rregullore:

1. Autorizimi i personave juridike për kryerjen e verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në ***Pjesën 1***, bashkangjitur.
2. Autorizimi i personave juridike për kryerjen e ekspertizës metrologjike jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në ***Pjesën 2***, bashkangjitur.
3. Autorizimi i personave juridike ose fizike për kryerjen e riparimit, verifikimit dhe vulosjes pas riparimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në ***Pjesën 3***, bashkangjitur.

## PJESA 1

### **“KERKESAT DHE PROCEDURA PER AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIK PER KRYERJEN E VERIFIKIMIT TE INSTRUMENTAVE MATES LIGJERISHT TE KONTROLLUAR ”**

#### Pika 1

Me këtë rregullore përcaktohen kërkesat që plotëson personi juridik si dhe procedura për marrjen e autorizimit për verifikimin e instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara si dhe për vulosjen e tyre.

#### Pika 2

Autorizimi për verifikim të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar jepet vetëm për instrumente të përcaktuar në përputhje me Nenin 40, paragrafi 2 i Ligjit për Metrologjinë dhe për një territor të caktuar (bazuar në ndarjen rajonale të aktivitetit të DPM) ose për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Pika 3

Për marrjen e këtij autorizimi personi juridik plotëson këto kushte :

#### ***A. Për të demonstruar aftësi për të marrë përgjegjësi:***

1. Të jete person juridik provuar me dokumentacionin ligjor përkatës
2. Nuk duhet të jete në proces gjyqësor ose përmbarimi për probleme që kanë lidhje me aktivitetin
3. Të ketë shlyer detyrimet shtetërore në fushën e tatim-taksave
4. Të përdorë tarifa verifikimi të miratuara nga Ministria e Financave

#### ***B. Për të demonstruar kompetencën e nevojshme teknike duhet të disponojë laborator të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, bazuar në standardin ISO 17025, ose duhet të plotësojë kërkesat si vijon:***

1. Të ketë laborator (ose autolaborator) të përshtatshëm për aktivitetin verifikues që do të kryejë i cili të plotësojë kushtet që lejojnë aplikimin e metodës së verifikimit të miratuar, nga DPM, për kategorinë përkatëse të instrumentit matës të përcaktuar.
2. Të ketë personel të aftë, të trajnuar dhe të kualifikuar me njohuri teknike dhe njohuri të përshtatshme për kërkesat ligjore për fushën dhe aftësi praktike për verifikim, lëshim certifikate dhe regjistrim.
3. Të ketë etalonë dhe instrumente kontrollues të përshtatshëm dhe me saktësi të nevojshme (për sigurimin e trasmetueshmërisë) të dokumentuar me certifikata përkatëse të vlefshme minimumi 6 muaj nga data e aplikimit.
4. Të përdorë aktet ligjore dhe nënligjore për metrologjinë si dhe udhëzimet tekniko-administrative të dala në zbatim të tij.
5. Të njohë dhe të zbatojë kërkesat e kësaj urdhërese dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin prej saj.
6. Laboratori të ketë një sistem të menaxhimit të cilësisë bazuar në ISO 17025.

### ***C. Te siguroje objektivitet dhe paanësi***

#### **Pika 4**

Procedura për dhënien autorizimit për verifikim fillon me plotësimin dhe nënshkrimin nga ana e përfaqësuesit të personit juridik, të kërkesës sipas modelit bashkangjitur kësaj Rregulloreje (Aneksi 1.1 )

#### **Pika 5**

Kjo kërkesë i drejtohet Drejtorise së Përgjithshme të Metrologjise (DPM) dhe përmban :

1. të dhënat për sistemin e menaxhimit të cilësise (të dhëna për specialistet, për etalonët- instrumentat matës kontrollues, saktësinë e tyre si dhe për regjistrat e verifikimit).
2. deklarin e përfaqësuesit të personit juridik, se i njeh dhe i pranon kriteret dhe kërkesat e kësaj Rregulloreje, Ligjin për Metrologjinë dhe aktet e tjera nënligjore që kanë lidhje me verifikimin.
3. një kopje të manualit të menaxhimit të laboratorit.
4. një dokument që të vërtetojë se ai do të përdorë tarifa verifikimi të miratuara nga Ministria e Financave (ose që të aplikuar pranë Ministrisë së Financave për miratim të tarifave)

#### **Pika 6**

1. Me të marrë kërkesën Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise (DPM), fillon procesin e vlerësimit për autorizim:

a. Fillimisht kryhet shikimi i aplikimit dhe i dokumentave bashkangjitur dhe gjykohet nëse kërkesat e përgjithshme janë plotësuar, brenda një afati kohor jo më shumë se 20 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës. Nëse është e nevojshme aplikanti ftohet të marrë masa korigjuese.

b. Pasi shikimi është bërë (dhe masat korigjuese të mundshme janë marrë në konsideratë) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise kryen vizitën e vlerësimit në personin juridik. Kjo vizitë bëhet jo më vonë se 30 ditë nga marrja e kërkesës. Gjatë vizitës kontrollon gjendjen e etalonëve dhe të instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet tekniko-administrative, si është implementuar sistemi i menaxhimit dhe vërtetësia e të gjithë të dhënave të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik. Nëse është e nevojshme aplikanti ftohet të marrë masa korigjuese.

2. Pasi i gjithë procesi i vlerësimit ka përfunduar dhe është vendosur që aplikanti plotëson të gjitha kërkesat, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjise (DPM) nxjerr një vendim administrativ për autorizim, të vlefshëm për një periudhë tre vjeçare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise (DPM) vendos për nxjerrjen e Vendimit Administrativ të autorizimit brenda 60 ditëve kalendarike nga aplikimi.

#### **Pika 7**

Më tej personit juridik i jepet Vendimi Administrativ i autorizimit (sipas modelit bashkangjitur – Aneksi 1.2) për ushtrimin e së drejtës për verifikimin dhe vënosjen e instrumentave matës.

Juridiksioni dhe zona e vlefmerisë së tij për ushtrimin e së drejtës për verifikim përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise (DPM)

#### Pika 8

Në raste te vecanta ,sidomos per grup instrumentat qe pecaktohen ne piken 3, te nenit 26, te ligjit Nr 9875, date 14.02.2008 “Per Metrologjine”, ndërmjet DPM dhe personit juridik, lidhet nje akt-marrëveshje (kontrate) me anën e së cilës rregullohen marrëdhëniet specifike midis dy palëve. Akt-marrëveshja është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare .

#### Pika 9

Me marrjen autorizimit, personi juridik ka të drejtë te kryeje aktivitetet verifikuese te pershkruara, të vulosë instrumentat mates te verifikuar dhe t'i lëshojë pronarit të tyre dokumentin qe verteton kete verifikim.

Dokumenti dhe vula ligjërojnë përdorimin e mjetit matës për një periudhë kohe deri ne verifikimin e rradhes te parashikuar ne aktet nen ligjore per metrologjine.

#### Pika 10

I autorizuari nuk ka të drejtë të bëjë verifikime jashte zones se juridiksionit te autorizuar si dhe nuk ka te drejte te ndërhyjë aty ku verifikimi eshte kryer nga strukturat e Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM).

#### Pika 11

I autorizuari per subjektet qe ndodhen ne zonen e juridiksionit te tij dhe qe nuk pranojne te verifikojne instrumentat mates ligjerisht te kontrolluar qe kane ne perdorim, njofton me shkrim organet e inspektimit metrologjik prane Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM) .

#### Pika 12

Pas dhënies së autorizimit personit juridik i bëhen kontrole vlerësuese (supervizuese) ana e Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM), jo më te rralla se 1 herë në 6 muaj. Ne përfundim te afatit 3 vjeçar të autorizimit, personi juridik ben përsëri kërkesë prane Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM), duke te ndjekur te njejten procedure te pershkruar. Brenda periudhes se pare trevjecare laboratori i personit juridik duhet te jete akredituar nga Drejtoria e Akreditimit bazuar ne standartin ISO 17025 (ose duhet te kete aplikuar per akreditim prane kesaj Drejtorie dhe te jete ne fazen e vlerësimit perfundimtar)

#### Pika 13

Në raste se gjatë kontroleve vlerësuese (supervizuese) vërtetohet se veprimtaria e personit juridik, (për të cilin është dhënë autorizimi) ka degraduar për shkaqe objektive (etalonëve, kuadrit profesional) ose subjektive (cilësia e punës së verifikimit), atëherë atij i tërhiqet autorizimi .

Për këtë është e domosdoshme mbajtja e një proces-verbali nga ana e Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM) në të cilën evidentohen shkaqet dhe të dhënat për degradimin e veprimtarisë verifikuese.

Në fund të proces-verbalit behet prononcimi me shkrim i përfaqësuesit të personit juridik.

#### Pika 14

Menjëherë pasi vendimi për tërheqje autorizimi është marre, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) njofton personin juridik.

#### Pika 15

Persoinit juridik, te cilit i eshte terhequr autorizimi nga Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM), i hiqet gjithashtu e drejta per riaplikim për autorizim per nje periudhe 5 vjecare.

Personit juridik, i cili heq dore vete nga autorizimi, i hiqet e drejta per riaplikimit per autorizim per nje periudhe 10 vjecare

#### Pika 16

Tarifa për dhënien e autorizimit per verifikim dhe te drejtes per vulosje për personat juridik percaktohet ne Udhezimin e Ministrise se Financave per pagesat dhe tarifat e sherbimeve te Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM).

#### Pika 17

Anekset e më poshtme janë plotësime të kësaj Rregulloreje:

1. Kërkesa për dhënien e autorizimit per verifikim te instrumentave matese ligjerisht te kontrolluara
2. Vendimi administrativ per autorizimin per verifikim

**Aneks nr.1.1**

**KËRKESË**  
**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PER VERIFIKIM TE INSTRUMENTAVE**  
**MATESE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA**

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit ( laboratorit) verifikues.....  
.....
2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit verifikues .....
3. Ndertesa dhe kushtet ambjentale te laboratorit .....
4. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit verifikues :  
---
5. Etalonët, instrumentat matës kontrolluese ( qe do te perdoren ne aktivitetin e verifikimit) dhe karakteristikat e tyre:  
---  
---
6. Llojet e instrumentave matëse që subjekti është në gjendje të verifikojë  
---  
---
7. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve të metrologjisë;  
---  
---
8. Deklaroj se nuk kryej riparimin e instrumentave mates ligjerisht te kontrolluar.
9. Deklaroj se njoh :
  - a. Ligjin Nr. 9875, date 14.02.2008 “Per Metrologjine”
  - b. Rregulloren per autorizimin e personave juridike per kryerjen e veprimtarive ne metrologjine ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave matese”
  - c. Te gjitha aktet nenligjore qe i perkasin verifikimit.
10. Gjithashtu marr persiper :
  - a. te repektoj plotesisht rregullat dhe detyrimet qe permbajne dokumentet e mesiperme
  - b. te bej pagesen e tarifes perkatese ne llogarine e DPM
  - c. te plotesoj regullisht dhe tja paraqese DPM-se (me kerkese te saj) regjistrimet dhe dokumentacionin qe i perket aktiviteteve te verifikimit dhe markimit

Duke pasur parasysh si më sipër , i parashtoj DPM-së kërkesën për të na dhënë autorizim per verifikim dhe vulosje te instrumentave matese qe kontrollohen ligjerisht.

SUBJEKTI .....

Perfaqesuesi

(.....)

**Aneks nr.1. 2**

Nr.....Prot. .... më ...../...../.....

**VENDIM ADMINISTRATIV**  
**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PER VERIFIKIM TE INSTRUMENTAVE**  
**MATES LIGJERISHT TE KONTROLLUARA**

Ne zbatim te Rregullores “Per autorizimin e personave juridike per kryerjen e veprimtarive ne metrologjine ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave matese” Subjektit Juridik ..... i jepet *Autorizimi per verifikim te instrumentave mates ligjerisht te kontrolluara :*

- 1.....
- 2.....
- .....

Etalonët dhe instrumentat matëse verifikuese që lejohen janë :

- 1....
- 2....
- .....

Kontrolli dhe verifikimi i instrumentave mates do te kryhet konform Urdheresave- rregulloreve....

- 1.....
- 2.....
- .....

Kryerjen e kontrollit dhe të verifikimit të instrumentave matëse e kanë të drejtë specialistët e më poshtëm

- 1.....
- 2.....
- .....

Llojet e instrumentave matëse që lejohen të verifikohen nga i autorizuari:

- 1.....
- 2.....

Zona e juridiksionit (teritoriale) per kryerjen e aktivitetit eshte.....

Ky autorizim hyn në fuqi më datën .....

Skadon me datën .....

Drejtori i Pergjithshem i DPM

(.....)



## **PJESA 2**

### **KERKESAT PER AUTORIZIM TE PERSONAVE JURIDIKE JASHTE DPM PER TE KRYER EKSPERTIZEN METROLOGJIKE**

#### **Pika 1**

Bazuar ne Ligjin Nr.9875, date 14.02.2008, “Per Metrologjine”, neni 40, pika 2 Drejtore i Pergjithshem i Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM) autorizon nje person juridik jashte DPM per te kryer ekspertizen metrologjike.

#### **Pika 2**

Ekspertiza metrologjike përfshin :

- Testimet jashte radhe te instrumentave matese ligjerisht te kontrolluara ne rast te dyshimit per funksionimin e rregullt te tyre dhe,
- Matjet zyrtare, domethënë matjet e kerkuara si prova (deshmi) ne prodedurat ose ne marrjen e vendimit nga trupa qeveritare ose gjykatat.

#### **Pika 3**

Personat juridik, te autorizuar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Metrologjise (DPM) per verifikim ose te akredituar nga Drejtoria e Akreditimit te Shqiperise per testimin e instrumentave mates ligjerisht te kontrolluar autorizohen per kryerjen e ekspertizes metrologjike per testim jashte radhe bazuar ne kerkesen perkatese dhe pa vleresimin e kompetences se tyre. Autorizimi jepet brenda 12 ditesh kalendarike pas marrjes se kerkeses dhe eshte i perdorshem per qellimin e shenuar dhe brenda afatit te vlefshmërisë se autorizimit per verifikim ose te akreditimit per testim.

#### **Pika 4**

Kerkesat qe duhet te plotesojne persona te tjere juridik jashte Drejtorise se Përgjithshme te Metrologjise (DPM) per te fituar autorizimin per kryerjen e ekspertizes metrologjike per testimin jashte radhe te instrumentave mates ligjerisht te kontrolluar jane te njejta si kerkesat e dhena ne Pjesen 1 (pika 3, geramat A, B,dhe C). Gjithashtu perdoret e njejta procedure e pershkruar ne Pjesen 1.

#### **Pika 5**

Kerkesat qe ploteson nje person juridik jashte Drejtorise se Pergjitheshme te Metrologjise (DPM) per te fituar autorizimin per kryerjen e ekspertizes metrologjike per matjet zyrtare jane si vijon:

A. Per te demonstruar aftesine per te marre pergjegjesi

1. Te jete person juridik provuar me dokumentacionin ligjor perkates
2. Te mos kete proces gjyqësor ne ngarkim te tij
3. Te kete plotesuar te gjitha detyrimet ligjore ne fushen e taksave

B. te demonstroje kompetencen teknike, *duke demonstruar qe disponon laborator te akredituar nga Drejtoria e Akreditimit*,

*ose duke plotesuar kerkesat si vijon*

- Te kete staf te kualifikuar dhe trainuar.
- Te disponoje pajisjet e nevojshme per te kryer matjet ne fushen e vecante te kompetences se tyre.
- Te kete njohuri te mjaftueshme mbi rregulloret, per standartet kombetare, nderkombetare dhe Europjane dhe per praktikat e matjeve.
- Gjate punes te siguroje paanësi (objektivitet) dhe ruajtjen e konfidencialitetit.
- Te siguroje evidenca per kontributet shkencore ose te matjeve (per shembull, arritje shkencore dhe te tjera, publikime, vleresime, pjesemarrje ne punime standartizimi ose akreditimi).
- Te kete nje sistem te menaxhimit te cilesise bazuar ne ISO/IEC 17025.

#### Pika 6

Procedura per dhenien e autorizimit per ekspertizen metrologjike per matjet zyrtare fillon me plotesimin dhe nenshkrimin e kerkese nga perfaqesuesi i personit juridik bazuar ne modelin e miratuar bashkangjitur kesaj Rregulloreje (Aneksi 2.1)

#### Pika 7

Kjo kerkese paraqitet prane Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise (DPM) dhe duhet te perfshije:

1. te dhena per sistemin e menaxhimit te cilesise (te dhena mbi specialistet, mbi standartet e matjes, mbi instrumentat mates e kontrollues, per saktesine e tyre, si dhe evidencat mbi kontributet e tyre shkencore dhe te matjeve).
2. deklarimin e perfaqesuesit te personit juridik qe njeh kerkesat dhe kriteret e kesaj Urdhërese dhe te akteve te tjera nënligjore qe i përkasin **verifikimeve**
3. nje kopje te manualit te menaxhimit te laboratorit

#### Pika 8

1. Me te marre kerkesen Drejtoria e Pergjitheshme e Metrologjise (DPM), fillon procesin e vleresimit per autorizim:

a. Fillimisht kryhet shikimi i aplikimit dhe i dokumentave bashkangjitur dhe gjykohet ne se kerkesat e pergjithshme jane plotesuar, brenda nje afati kohor jo me shume se 20 dite kalendarike nga marrja e kerkeses. Ne se eshte e nevojshme aplikanti ftohet te marre masa korigjuese.

b. Pasi shikimi eshte bere (dhe masat korektive te mundeshme jane marre ne konsiderate) Drejtoria e Pergjitheshme e Metrologjise (DPM), bazuar ne kekesat e dhena ne piken 5, kryen vizitën e vlerësimit në personin juridik. Kjo vizitë bëhet jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës. Gjatë vizites kontrollohet gjendja e etalonëve dhe e instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet tekniko-administrative, si është implementuar sistemi i menaxhimit dhe vërtetësia e të gjithë të dhënave të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik. Ne se eshte e nevojshme aplikanti ftohet te marre masa korektive.

2. Pasi i gjithë procesi i vleresimit ka përfunduar dhe është vendosur që aplikanti ka plotësuar të gjitha kërkesat, drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) nxjerr një vendim administrativ për autorizim, të vlefshëm për një periudhë tre vjeçare.

3. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) vendos për nxjerrjen e Vendimit Administrativ të autorizimit (Aneksi 2.2) brenda 60 ditëve kalendarike nga aplikimi.

#### Pika 9

Pas dhënies së autorizimit Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) kryen kontrolle vlerësuese (supervizuese) ndaj personit juridik të pakten një here brenda periudhës së vlefshmerisë së autorizimit.

Ne mbarim të periudhës tre vjeçare të autorizimit personi juridik paraqet një kërkesë të re pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), duke ndjekur të njëjten procedurë. Brenda periudhës së parë trevjeçare laboratori i personit juridik duhet të jetë akredituar nga Drejtorja e Akreditimit bazuar në standartin ISO 17025 (ose duhet të ketë aplikuar për akreditim pranë kesaj Drejtorie dhe të jetë në fazën e vlerësimit përfundimtar).

#### Pika 10

Në raste se gjatë kontrolleve vlerësuese (supervizuese) vërtetohet se veprimtaria e personit juridik, (për të cilin është dhënë autorizimi) ka degraduar për shkak objektiv (etalonëve „kuadrit profesional) ose subjektiv (cilësia e punës së aktivitetit të ekspertizës metrologjike), atëherë atij i tërhiqet autorizimi.

Për këtë mbahet një proces-verbal nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) në të cilën evidentohen shkaqet dhe të dhënat për degradimin e veprimtarisë verifikuese (të heqjes së autorizimit për aktivitetin e ekspertizës metrologjike).

Në fund të proces-verbalit bëhet prononcimi me shkrim i përfaqësuesit të personit juridik.

#### Pika 11

Menjëherë pasi vendimi për tërheqje të autorizimit është marrë, Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) njofton personin juridik.

#### Pika 12

Anekset e më poshtme janë plotësime të kësaj rregulloreje:

1. Kërkesa për dhënien e autorizimit për kryerjen e ekspertizës metrologjike
2. Vendimi administrativ për autorizimin për kryerjen e ekspertizës metrologjike

**Aneks nr.2.1**

**KËRKESË**  
***PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PER PERSONAT JURIDIK JASHTË DPM PER***  
***KRYERJEN E EKSPERTIZES METROLOGJIKE***

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit ( laboratorit) verifikues.....  
.....
2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit verifikues .....
3. Ndertesa dhe kushtet ambjentale te laboratorit .....
4. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit verifikues :  
---
5. Etalonët, instrumentat matës kontrolluese ( qe do te perdoren ne aktivitetin e ekspertizes metrologjike ) dhe karakteristikat e tyre:  
---  
---
6. Llojet e instrumentave matëse që subjekti është në gjendje të verifikojë  
---  
---
7. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve të metrologjisë;  
---  
---
8. Deklaroj se nuk kryej riparimin e instrumentave mates ligjerisht te kontrolluar.
9. Deklaroj se njoh :
  - a. Ligjin nr.9875, date 14.02.2008, “Per Metrologjine”
  - b. Rregulloren “Per autorizimin e personave juridike per kryerjen e veprimtarive ne metrologjine ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave matese”
  - c. Te gjitha aktet nenligjore qe i perkasin ekspertizes metrologjike.
10. Gjithashtu marr persiper :
  - a. te repektoj plotesisht rregullat dhe detyrimet qe permbajne dokumentet e mesiperme
  - b. te bej pagesen e tarifes perkatese ne llogarine e DPM
  - c. Te plotesoj regullisht dhe tja paraqese DPM-se ( me kerkese te saj) regjistrimet dhe dokumentacionin qe i perket aktiviteteve te ekspertizes metrologjike

Duke pasur parasysh si më sipër , i parashtroj DPM-së kërkesën për të na dhënë autorizim per kryerjen e ekspertizes metrologjike..

SUBJEKTI .....

Perfaqesuesi

**Aneks nr.2. 2**

Nr.....Prot. .... më ...../...../.....

**VENDIM ADMINISTRATIV  
PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE JASHTE DPM PER KRYERJEN E  
EKSPERTIZES METROLOGJIKE**

Ne zbatim te Rregullores “Per autorizimin e personave juridike per kryerjen e veprimtarive ne metrologjine ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave matese” Subjektit Juridik ..... i jepet **Autorizimi per kryerjen e ekspertizes metrologjike** :

1.....

2.....

.....

Etalonët dhe instrumentat matëse verifikuese që lejohen janë :

1....

2....

.....

Ekspertiza metrologjike kryhet konform Urdheresave-dhe /ose rregulloreve....

1.....

2.....

.....

Kryerjen e ekspertizes metrologjike kanë të drejtë specialistët e më poshtëm

1.....

2.....

.....

Llojet e aktiviteteve te ekspertizes metrologjike qe lejohen te kryhen nga i autorizuari:

1.....

2.....

Ky autorizim hyn në fuqi më datën .....

I vlefshem deri me datën .....

Drejtori i Pergjithshem i DPM

(.....)

### PJESA 3

#### **“KERKESAT DHE PROCEDURA PER DHËNJEN E AUTORIZIMIT PER RIPARIM, VERIFIKIM DHE VULOSJE TË INSTRUMENTAVE MATËSE LIGJERISHT TE KONTROLLUAR**

##### Pika 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, të cilat duhet të plotësojë personi juridik ose fizik për marrjen e të drejtës (autorizimit) për riparim, verifikim dhe për vulosje të instrumentave mates ligjerisht të kontrolluar.

##### Pika 2

a. Në bazë të Ligjit Nr.9875, date 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, neni 21, pika b, përdoruesi i instrumentave mates ligjerisht të kontrolluara në përdorim ka për detyrë të mirembaje instrumentat mates ligjore në kushte teknike që sigurojnë saktësinë e matjeve.

b. Në periudhën ndërmjet dy verifikimeve periodike të njëpasnjëshme të një instrumenti matës, shpesh ndodhë që ai të defektohet gjatë përdorimit. Në këto raste nga pronari duhet të merren masa për riparimin e tij.

c. Me qene se pas riparimit instrumenti mates duhet të verifikohet (verifikim i cili në këto rast është i pa planifikuar të kryhet nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjisë (DPM) ose subjekti i autorizuar prej saj) atëherë lindë nevoja që kjo e drejtë t’i jepet përkohësisht riparuesit. Kjo bën të mundur që instrumenti matës të mund të përdoret nga subjekti menjëherë pas riparimit

##### Pika 3

Ky dokument përcakton kriteret që plotësohen për dhënien subjektit juridik, fizik, nga ana e Drejtorisë së Pergjithshme të Metrologjisë (DPM), të së drejtës (autorizimit) për riparimin, verifikimin dhe vulosjen me vlefshmëri të përkohshme **nje mujore** të instrumentave mates që i nënshtrohen verifikimit të detyrueshëm periodik ligjor.

##### Pika 4

Për marrjen e autorizimit personi juridik, fizik duhet të plotësojë këto kushte të më poshtme:

#### ***A. Per te demonstruar afteste per te marre pergjegjesi:***

1. Të jete person juridik provuar me dokumentacionin ligjor perkates
2. Nuk duhet të jete në proces gjyqësor ose përmbarimi për probleme që kanë lidhje me aktivitetin
3. Të kete shlyer detyrimet shtetërore në fushën e tatim- taksave

#### ***B.Per te demonstruar kompetencen e nevojshme teknike:***

1. Të disponojë licence teknike për fushën që mbulon aktivitetin riparues që ai kërkon (ose të ngjajshme me të) ose:
  - Të disponojë paisje teknike të nevojshme

- Te kete kryer aktivitet riparues ne fushen qe kerkon te autorizohet
2. të ketë personel të aftë,
  3. të ketë etalonët dhe instrumentet matëse të saktësisë së nevojshme të dokumentuara me certifikata përkatëse.
  4. të përdorë aktet ligjore dhe nenligjore për metrologjinë si dhe udhëzimet tekniko-administrative të dala në zbatim të tij.
  5. të njohë dhe të zbatojë kërkesat e kësaj urdhërese dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin prej sajë.

#### Pika 5

Procedura për dhënien e së autorizimit për riparim, verifikim dhe për vulosje të përkohshme fillon me plotësimin dhe nënshkrimin nga ana e përfaqësuesit të personit juridik, fizik riparues, të kërkesës sipas modelit bashkangjitur këtij Urdhri (Aneksi 3.1).

#### Pika 6

Kjo kërkesë i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) dhe përmban:

1. të dhëna për riparuesit, për etalonët (instrumentet matës kontrollues), saktësinë e tyre, për regjistrat e vulosjes së përkohshme dhe për dokumentet e tjera që i përkasin aktivitetit.
2. deklarinë e përfaqësuesit të personit juridik, fizik se e njeh dhe i pranon kriteret dhe kërkesat e kësaj Rregulloreje.

#### Pika 7

1. Me të marrë kërkesën Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), fillon procesin e vlerësimit për autorizim:

a. Kryhet një shikim i aplikimit dhe dokumentave bashkangjitur dhe gjykohet nëse kërkesat e përgjithshme janë plotësuar. Nëse është e nevojshme aplikanti ftohet të marrë masa korigjuese.

b. Pasi shikimi është bërë (dhe masat korigjuese të mundshme janë marrë në konsideratë) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) kryen vizitën e vlerësimit në personin juridik, fizik. Kjo vizitë bëhet jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës. Gjatë kësaj vizite kontrollohet gjendja e pajisjeve riparuese, e etalonëve dhe e instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet administrative për kushtet metrologjike dhe vërtetësia e të gjithë të dhënave të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik, fizik. Nëse është e nevojshme aplikanti ftohet të marrë masa korigjuese.

2. Pasi i gjithë procesi i vlerësimit ka përfunduar dhe është vendosur që aplikanti ka plotësuar të gjitha kërkesat, drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) nxjerr një vendim administrativ për autorizim, të vlefshëm për një periudhë tre vjeçare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) vendos për nxjerrjen e vendimit administrativ të autorizimit brenda 30 ditëve kalendarike nga aplikimi.

#### Pika 8

Menjëherë personit juridik, fizik i jepet Vendimi administrativ për autorizim për riparim, verifikimin dhe vulosje të përkohshme të instrumentave matëse ligjerisht të kontrolluara (sipas modelit bashkangjitur Aneksi 3.2)

#### Pika 9

Me marrjen e autorizimit, personi juridik, fizik riparues ka të drejtë që pas riparimit të instrumentit matës ta verifikojë, ta vulosë atë dhe t'i lëshojë pronarit të tij një certifikatë (dokument) verifikimi .

Certifikata dhe vula ligjërojnë përdorimin e instrumentit matës për një **periudhë një mujore**.

Menjëherë pas vulosjes dhe dhënës së certifikatës, riparuesi njofton Drejtorinë e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) se ku është bërë vulosja e përkohshme, me qëllim që verifikimi jashtë radhe përkatës i instrumentit të riparuar të kryhet brenda afatit ligjor 30 ditor (kalendarike).

#### Pika 10

Riparuesi nuk ka të drejtë të bëjë shënime në Librezën (dokumentin) e verifikimit të instrumentit matës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

#### Pika 11

Brenda një muaji nga dita e vulosjes së instrumentit matës prej personit juridik, fizik riparues, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose personi juridik i autorizuar për verifikim, bën verifikimin e instrumentit matës të pajisur me leje të përkohshme dhe sipas gjendjes verifikuese zëvendëson ose jo vulën dhe certifikatën e personit juridik, fizik riparues me ato të vetat.

#### Pika 12

Për rastin kur gjatë kryerjes së këtij verifikimit jashtë radhe (që kryhet nga metrologu i autorizuar) instrumenti matës i vulosur nga personi juridik, fizik riparues, rezulton i pa rregullt dhe nëse mbi instrumentin matës nuk ka ndërhyrje teknike nga të tjerët dhe nëse ai është mbajtur në kushte të përshtatshme, shpenzimet e verifikimit i paguan riparuesi.

#### Pika 13

Pas dhënies së autorizimit personit juridik, fizik riparues i bëhen kontrole vlerësuese (supervizuese) nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), jo më rralla se 1 herë në 6 muaj.

Me përfundimin e afatit tre vjeçar të lejes, personi juridik, fizik riparues duhet t'i bëjë përsëri kërkesë DPM-së sipas pikës 5, të cilat përsërisin të njëjtën procedurë të autorizimit.

#### Pika 14

Në raste se gjatë kontrolleve vlerësuese (supervizuese) vërtetohet se veprimtaria e personit juridik, fizik riparues (për të cilin është dhënë autorizimi) ka degraduar për shkak objektiv (etalonëve, kuadrit profesional) ose subjektiv (cilësia e punës së riparuesit), atëherë atij i tërhiqet autorizimi.

Për këtë mbahet një proces-verbal nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) në të cilën evidentohen shkaqet dhe të dhënat për degradimin e veprimtarisë verifikuese.



Në fund të proces-verbalit behet prononcimi me shkrim i përfaqësuesit të personit juridik, fizik riparues .

#### Pika 15

Menjehere me marrjen e vendimit për terheqjen e autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise (DPM) njofton personin juridik, fizik riparues.

#### Pika 16

Tarifat për dhënien për personat juridik, fizik riparues te autorizimit per riparim,verifikim për vulosje të perkohshme të instrumentave mates parashikohen ne Udhëzimin e Ministrisë se Financave per pagesat dhe tarifat e sherbimeve te Drejtorise se Përgjithshme te Metrologjise (DPM).

#### Pika 17

Anekset e më poshtme janë plotësime të kësaj rregulloreje:

1. Kërkesa për dhënien e autorizimit te për riparim, verifikim dhe vulosje te perkoheshme te instrumentave mates ligjerisht te kontrolluara.
2. Vendimi administrativ per autorizim për riparim, verifikim dhe vulosje te perkoheshme te instrumentave matese ligjerisht te kontrolluara.

**KËRKESË**  
**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT**  
**PER RIPARIM, VERIFIKIM DHE PËR VULOSJE TË PËRKOHËSHME TË**  
**INSTRUMENTAVE MATËSE LIGJERISHT TE KONTROLLUARA**

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit riparues.....  
.....
2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit riparues .....
3. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit riparues verifikues :  
---  
---
4. Etalonët, instrumentet matëse kontrolluese dhe karakteristikat e tyre:  
---  
---
5. Llojet e instrumenteve matëse që subjekti është në gjendje të riparoje  
---  
---
6. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve të metrologjisë;  
---  
---
7. Deklaroj se njoh:
  - a.Ligjin nr.9875, date 14.02.2008, “Për Metrologjinë”
  - b.Rregulloren “Per autorizimin e personave juridike per kryerjen e veprimtarive ne metrologjine ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave matese”
  - c.Aktet e tjera nenligjore te metrologjise qe i perkasin verifikimit
8. Gjithashtu marr përsipër:
  - a.Të respektoj plotësisht rregullat dhe detyrimet e përmbajtura në dokumentacionet e më sipërme,
  - b.Të derdh në llogarinë rrjedhëse të DPM-së Nr.....shumen sipas tarifës perkatese te miratuar nga Ministria e Financave
  - c.Të plotësoj rregullisht dhe të paraqes sa herë që të më kërkohet nga DPM-ja regjistrimin dhe dokumentacionin qe i perket aktiviteve te verifikimit dhe vulosjes (markimit)

Duke pasur parasysh si më sipër, i parashtoj DPM-së kërkesën për të na dhënë autorizimin për riparim, verifikim dhe për vulosje të përkohshme të instrumentave matëse ligjërisht te kontrolluara

Firma.....  
Përfaqësuesi i firmës  
(.....)

**Aneksi 3.2**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_

**VENDIM ADMINISTRATIV PER AUTORIZIM  
PER RIPARIM, VERIFIKIM DHE VULOSJE TE INSTRUMENTAVE MATES  
LIGJERISHT TE KONTROLLUAR**

Subjektit juridik, fizik ..... i jepet e drejta që në zbatim të Rregullores “Për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizike për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse” *te riparoje, te verifikojë dhe të vulosë përkohësisht për një muaj, instrumentet matës ligjërish të kontrolluar.*

Etalonët dhe instrumentet matëse verifikuese që lejohen janë :

- 1.-----
- 2.-----
- 

Kontrolli dhe verifikimi i instrumenteve matëse do të kryhet me dokumentacionin ligjor, teknik, administrativ:

- 1.----
- 2.----
- 

Kryerjen e riparimit dhe të verifikimit të instrumenteve matëse të riparuar e kanë të drejtë specialistët e më poshtëm:

- 1.----
- 2.----
- 

Llojet e instrumenteve matëse që lejohen riparohen, të verifikohen dhe vulosen nga subjekti:

- 1.---
- 2.---

Ky autorizim hyn në fuqi më datën .....

I vlefshëm deri me datën .....

Drejtori i Përgjithshëm i DPM

(.....)